



RAPORT VJETOR 2020-2021

A. PËRSHKRIM I NJSBCZHK.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK) është njësi e ngritur në nivel universiteti. Përbërja dhe funksionimi i kësaj njësie është miratuar nga Rektori. Mënyra e funksionimit të NJSBCZHK rregullohet me rregullore të veçantë.

Kjo njësi përbëhet nga 10 anëtarë: drejtuesja e zyrës, anëtarë të tjerë të kësaj zyre që janë përzgjedhur nga pedagogët e çdo departamenti, përfaqësues nga administrata, si dhe një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve.

Kjo njësi është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë dhe ruajtjen e standarteve në UMSH, bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë në Shqipëri, strategjisë për zhvillim, politikave dhe akteve rregullatore të institucionit. NJSBCZHK përmes mekanizmave të sigurimit të cilësisë, dhe shumë proceseve të tjera të vazhdueshëm monitoron, vlerëson, ruan dhe përmirëson cilësinë e institucionit dhe të programeve të ofruara.

NJSBCZHK vlerëson në mënyrë periodike efikasitetin e veprimtarive mësimore, kërkimore ose artistike, si dhe efikasitetin e veprimtarive administrative të institucionit.

Secili anëtar i NJSBCZHK përgatit raportin e vlerësimit për veprimtarinë e monitoruar dhe mban përgjegjësi të plotë deri në dorëzim të raportit me shkrim dhe të firmosur në dosjen e njësisë.

NJSBCZHK-ja ka autonomi operative dhe akses në të dhënat e institucionit.

Të gjitha rezultatet e planveprimit të NJSBCZHK publikohen përmes një raporti të brendshëm që i dërgohet Rektorit të UMSH.

Në varësi të vlerësimit dhe monitorimit, çdo raportim që lidhet me Fakultetet përkatëse i vihen në dispozicion edhe Dekanëve të Fakulteteve dhe Drejtuesëve të Njësisë Bazë.

Raporti vjetor i njësisë dhe tërësia e veprimtarisë (dokumenta, raporte, etj) dorëzohet tek Rektori në fund të vitit akademik.

B. METODOLOGJIA E PUNËS

Metodologjia e punës së kësaj njësie është e bazuar në: Rregulloren e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave, manualin e saj, Ligjin e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Nr.80/2015; Date 22.07.2015; Neni 103 dhe 104, Statutin e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë; Nenin 53 dhe 84 dhe në rregulloren e UMSH neni 28, si dhe të gjitha dokumentet e ASCAL-it.

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka në vëmendje parësore, sigurimin e cilësisë, ndaj operon për rritjen e saj në bashkëpunim me NJSBCZHK.

1. Në fillim të vitit akademik, NJSBCZHK ka paraqitur në Rektorat planveprimin e kësaj zyre, i cili është hartuar në bazë të politikave dhe strategjive institucionale për zhvillimin, përmirësimin dhe ruajtjen e standarteve.
2. Planveprimi është i përbërë nga 22 rubrika të shtrira në periudha të ndryshme të vitit akademik 2020-2021, sipas kalendarit të po të këtij viti. Hartimi i këtyre rubrikave ka si qëllim sigurimin e cilësisë dhe ruajtjen e standarteve sipas udhëzimeve të ASCAL. Planveprimi i miratuar nga Rektori ndiqet me rigorozitet nga NJSBCZHK në drejtim të: mësimdhënies, studentëve, cilësisë, dokumenteve dhe kërkimit shkencor.
3. Duke qenë se mësimi është zhvilluar online këtë vit, edhe monitorimet apo të gjitha veprimtaritë janë kryer online.
4. Pas çdo procesi të planveprimit, NJSBCZHK dorëzon në Rektorat, raportet e nxjerra nga monitorimet, vlerësimet, apo veprimtaritë e tjera. Në fund të vitit akademik, së bashku me raportet e çdo procesi, NJSBCZHK dorëzon edhe raportin vjetor në Rektorat.
5. Të gjitha monitorimet, vlerësimet dhe aktivitetet e kësaj njësie ruhen në dosje të veçantë në NJSBCZHK për vitin akademik 2020-2021
6. Në proceset e vazhdueshme të kësaj njësie janë përfshirë të gjithë anëtarët e NJSBCZHK të caktuar në organigramën e miratuar.
7. Ndarja e detyrave për çdo anëtar të njësisë është bërë në mënyrë propocionale dhe transparente, ku të pranishëm në të gjitha proceset kanë qenë të gjithë anëtarët e NJSBCZHK.
8. Çdo anëtar i njësisë, dorëzon raport të veprimtarisë në formë elektronike dhe në hardcopy të firmosur pas çdo aktiviteti monitorues.

9. NJSBCZHK, ka zhvilluar takime online para çdo procesi. Këto takime janë të zbardhura me procesverbale të vecanta, dhe u janë vënë në dispozicion Rektoratit me dorëzimin e dosjes në fund të vitit akademik.
10. NJSBCZHK ka operuar në mënyrë të pavarur për vlerësimin dhe monitorimin e proceseve të ndryshme dhe ka respektuar detajet e miratuara në planveprimin e miratuar nga Rektori. Me kërkesë të Rektoratit, ka kryer edhe veprime të tjera administrative sipas rastit.
11. Në të gjitha rastet Rektorati dhe Drejtuesit e njësive bazë janë vënë në dijeni me email përpara çdo fillimi të proceseve të ndryshme të punës së NJSBCZHK, duke kërkuar mirëkuptimin dhe bashkëpunimin e tyre që çdo anëtar të marrë të dhënat e nevojshme sipas rastit që është vlerësuar.

C. VEPRIMTARITË E KRYERA DHE AKTIVITETET E VLERËSUARA NGA NJSBCZHK PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021 NË UMSH

1. Si çdo fillim viti, NJSBCZHK ka zhvilluar takime, këtë vit online, për mënyrën e monitorimit dhe raportimit të çdo procesi. Anëtarët e NJSBCZHK kanë detyrimin që të bëjnë raport me shkrim për çdo proces monitorimi apo vlerësimi në grupe prej 2 apo 3 personash, sipas rastit. Këto takime kanë pasur si qëllim trajnimin e anëtarëve për mënyrat e monitorimeve për procese të ndryshëm si dhe shpërndarjen e model raporteve të përbashkët
2. **NJSBCZHK** është kujdesur përgjatë gjithë vitit akademik 2020-2021 që në SHARE FOLDER, UMSH Dokumentacione të hidhen të gjitha materialet e nevojshme për stafin akademik dhe administrativ, ku sipas nevojave apo proceseve të ndryshëm, individidët e lejuar aksesojnë materialet përkatëse. Dokumentave ekzistues u janë shtuar edhe dokumentat e këtij viti akademik, psh folderat e syllabuseve për cdo departament për të dy ciklet e studimit.
3. Në fillim të vitit akademik 2020-2021 NJSBCZHK, në kuadër të ruajtjes së nivelit të cilësisë në UMSH, të zhvillimeve në kuadrin ligjor si dhe garantimin nga ana e institucionit të nivelit të kërkuar për standartet e stafit akademik, Rektorati ka kërkuar organizimin e Trajnimit të të gjithë stafit akademik dhe atij administrativ, ku NJSBCZH ka dhënë një kontribut të rëndësishëm.

4. Përgjatë trajnimit të zhvilluar online me të gjithë stafin në periudhën dhjetor-janar 2021, NJSBCZHK ka qenë përgjegjëse për trajnimin: Mbi aktet rregullatore dhe procedurat e procesit mësimor (viti akademik 2020-2021). Pedagogët e rinj por edhe ata me eksperiencë në UMSH u njohën dhe u trajnuan për mënyrën e zhvillimit të provimeve, duke filluar nga hartimi i tezës e deri në hedhjen e notës përfundimtare. Pedagogët u njohën dhe trajnuar për respektimin e procedurave dhe formateve të miratuara nga Rektori si dhe respektimin e zhvillimit të mësimin në platformën G-Suite. Pedagogët u trajnuan për mënyrën e vlerësimit për secilin nga llojet e provimeve.
5. Gjithashtu NJSBCZHK ka zhvilluar edhe trajnimin online me stafin akademik dhe administrativ: Mbi kërkesat për përgatitjen, ruajtjen e administrimin e dokumentacionit sipas hierarkisë gjatë ushtrimit të detyrës në UMSH. Të gjithë u trajnuan dhe udhëzuan dhe për ruajtjen e dokumentacionit, për të cilin janë përgjegjës sipas procedurave dhe proceseve përkatëse gjatë një viti të plotë akademik. Të gjithë u njohën me metodologjinë e hartimit të syllabusit dhe çdo formati tjetër dokumentar. Pedagogët u njohën dhe rikujtuan edhe me mënyrën e ndërveprimit me Sekretarinë Mësimore dhe njësitë e tjera ndihmëse (Biblioteka, Laboratorët, etj.)
6. Po në fillim të vitit akademik, NJSBCZHK ka dhënë një kontribut në udhëzimin e pedagogëve në lidhje me Mbarëvajtjen e zhvillimit të mësimin online për vitin akademik 2020-2021, me specifikisht për platformën G-Suite, Google Classroom dhe Google meeting. Nisur nga vështirësitë prej situatës së Pandemisë, zhvillimit të mësimin iu shtuan edhe disa procedura të tjera, duke filluar që me krijimin e klasave në Classroom e deri tek raportimi i pedagogut në fillim dhe mbarim të mësimin, në filen e sekretarisë mësimore dhe në në file-n e Zyrës së Burimeve njerëzore.
7. Duke u bazuar në planveprimin e vitit akademik 2020-2021, NJSBCZHK në bashkëpunim me drejtuesit e njësisë bazë ka ndërtuar dhe zhvilluar programin SEMESTRAL për monitorimin e zhvillimit të mesimit online. Programi është hartuar duke pasur parasysh objektivat e departamenteve dhe të vetë njësisë. Në përfundim të procesit në të dy semestrat, planit të punës për monitorimin e zhvillimit të mësimin i janë bashkëngjitur edhe formularët e vlerësimeve për çdo pedagog. Për këtë vit akademik, duke qenë se mësimi është zhvilluar online, formularit të vlerësimit (F5 në UMSH Dokumentacione) i është bashkëlidhur edhe një foto e auditorit online nga ora mësimore përkatëse. Sipas planit

përkatës, në orën mësimore të caktuar ka pasur përfaqësues nga departamenti dhe përfaqësues nga NJSBCZHK. Të dy anëtarët kanë detyrimin e plotësimit dhe dorëzimit të formularit të vlerësimit për çdo pedagog dhe lëndë.

8. Duke u bazuar në Kalendarin Akademik të UMSH për 2020-2021, NJSBCZHK ka mbajtur kontakte të rregullta me koordinatorët e fakulteteve dhe sekretarinë në lidhje me njoftimet e studentëve për secilin proces akademik.
9. Në këtë vit akademik, NJSBCZHK ka qenë pjesë e grupit për mirëmbajtjen e Faqes zyrtare të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, duke kontribuar në rishikimin e rubrikave për materialet që bëhen publike në këtë faqe.
10. Për një funksionim sa më të drejtë dhe transparent të TUTORIATIT AKADEMIK, NJSBCZHK ka dhënë kontributin e saj për organizimin dhe dokumentimin e këtij procesi. Bazuar në organigramën e Zyrës së Këshillimit të studentëve dhe karrierës, NJSBCZHK ka përcaktuar pedagogët tutorë, të cilët kanë krijuar klasa të vecanta në Classroom për takimet e tutorëve me studentët sipas programit të studimit në Bachelor. Kjo njësi ka monitoruar implementimin dhe respektimin e udhëzimit “Mbi autoritetin e tutorit në UMSH” duke monitoruar gjithë procesin e Tutoriatit që është zhvilluar përgjatë këtij viti akademik.
11. Për sa i përket cilësisë së mësimdhënies në UMSH, NJSBCZHK i ka kushtuar një rëndësi të veçantë edhe takimeve online me grupe studentësh të përfaqësuar nga senatorët e këshillit studentor UMSH. Nisur nga situata e pandemisë, takimet me Këshillin studentor kanë qenë më të shpeshta, për të kuptuar dhe ndjekur problematikat apo sqarimet për lëndë dhe çështje të ndryshme akademike. Të gjitha takimet me përfaqësuesit e studentëve kanë procesverbal takimi të veçantë. Këto takime kanë bërë të mundur krijimin e një elementi thelbësor për marrjen e reagimeve të drejtpërdrejta, pikëpamjeve dhe opinionëve nga studentët e UMSH.
12. Në kuadër të planveprimit të NJSBCZHK, janë realizuar edhe monitorimet e syllabuseve në UMSH Dokumentacione sipas folderave të departamenteve përkatës. Monitorimet e syllabuseve të miratuar janë kryer në fillim të çdo semestri. Grupet e punës janë ndarë në dy persona për secilin grup dhe kështu raporti i monitorimit mban firmën e dy anëtarëve të NJSBCZHK. Qëllimi i këtij monitorimi nga ana e NJSBCZHK ka qenë respektimi i

formatit të programit të lëndës sipas VKM 879. Pas monitorimeve semestrale, NJSBCZHK i ka përcjell raportet në Rektorat dhe më tej është vijuar monitorimi për përmirësimin e ndonjë elementi të mundëshëm tek ndonjë lëndë. Kopje të raporteve gjenden edhe në dosjen e NJSBCZHK për vitin akademik 2020-2021.

D. ANALIZË E VEPRIMTARIVE TË KRYERA PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021.

1. Nisur nga përvoja e viteve të kaluar akademik, NJSBCZHK ka identifikuar se krijimi i SHARE FOLDER me UMSH Dokumentacione si dhe pasurimi i tij me foldera të ndryshëm u ka dhënë mbështetje shumë proceseve akademike dhe monitoruese të vetë proceseve nga NJSBC:

- Në çdo moment pedagogët dhe përgjegjësit e departamenteve kanë aksesuar për nxjerrjen e rregulloreve, formateve, udhëzimeve etj; sigurisht sipas nevojave.
- SHARE FOLDER me UMSH Dokumentacione ka ndihmuar grupet e punës për akreditime dhe liçensime programesh që gjejnë në kohë reale të gjitha dokumentacionet e nevojshme për raportet e ndryshme.

2. Syllabuset e depozituara nga vetë drejtuesit e njësisë bazë në NJSBCZHK, për qëllimin e grumbullimit të tyre në SHARE Folder, pasi janë hedhur në të, kanë kaluar në proces monitorimi edhe për vitin akademik 2020-2021.

3. Që me fillimin e vitit akademik 2020-2021, bazuar në situatën e izolimit për shkak të pandemisë, NJSBCZHK ka dhënë kontributin e saj për ide mbi realizimin shumë proceseve akademike online, me qëllim që çdo proces i zhvilluar online të ketë gjurmën përkatëse në Google Classroom dhe Google meeting. Më specifikisht, NJSBCZHK ka qenë edhe pjesë e trajnimeve të fillim vitit akademik, me prezantime për disa procese, për pedagogët e rinj, por edhe ata me eksperiencë në UMSH.

- Në kuadër të përpjekjeve për përmirësimin e mëtejshëm të punë në drejtim të mësimdhënies, ruajtjes së standarteve dhe cilësisë, si dhe tërësisë të jetës studentore në UMSH, që në fillim të vitit akademik dhe deri në përfundim të tij, NJSBCZHK ka

monitoruar takimet online të studentëve me tutorët akademik, ku në të gjitha rastet ka qenë pjesë e njoftimeve për zhvillimin e tyre si dhe e pranishme gjatë takimit online. Të qenit prezent, në këto takime, ka bërë të mundur që njësia të marrë feedbackun e studentëve, të të gjitha programeve në lidhje me procese të ndryshme akademike të këtij viti.

- Po një herë në muaj, NJSBCZHK ka qenë prezente edhe në takimet me Këshillin studentor, nga i cili ka marrë shumë të dhëna mbi mbarëvajtjen e procesit mësimor, të cilat më pas i ka përcjell në Rektorat, sipas rastit dhe nevojës. (procesverbalet e takimeve me Këshillin studentor të dorëzuara në dosjen e NJSBCZHK për rektorat. Takimet janë zhvilluar online për shkak të izolimit nga Pandemia Covid, në klasën online të krijuar posacërisht, dhe në orën 14:00.
- Procesi i monitorimit të mësimit, sipas kalendarit të përcaktuar në bashkëpunim me drejtuesin e departamentit ka vijuar përgjatë gjithë vitit akademik. Kalendarit monitorues ka qenë semestral. Për çdo monitorim është realizuar raport vlerësimi dhe foto përkatëse, nga anëtari i NJSBCZHK si dhe dhe përgjegjësi i departamentit.

Në përfundim të këtyre proceseve janë dorëzuar raporte në rektorat, në formë elektronike si dhe në dosjen vjetore.

- ✓ Vlen për t'u theksuar fakti se studentët kanë qenë tepër aktivë përgjatë takimeve dhe të gatshëm për shprehur mendimin dhe vlerësimin e tyre për pedagogët, lëndët dhe gjithë procesin mësimor. Në të dy semestrat, studenët kanë qenë aktivë, me prezencën e tyre në klasat e krijuara për takime por edhe me sygjërimet për ndonjë përmirësim të mundshëm të procesit online, ose të ndonjë lënde të caktuar. procesi, janë dorëzuar në rektorat, 6 procesverbalet e takimeve, me gjetjet përkatëse, ku mund të theksohet fakti që studentët u ndjenë të lirshëm të shprehnin kënaqësitë dhe pakënaqësitë në lidhje me stafin akademik dhe procesin mësimor. Gjithashtu u vu re një gadishmëri e studentëve të UMSH për të ruajtur standartet e larta të institucionit. Studentët vlerësuan në mënyrë të kënaqëshme rreth 90 % të pedagogëve, si dhe shprehën nevojat për përmirësim të një pakice pedagogësh, ku sipas tyre kjo pakicë duhet të punojë më shumë për të qenë më fleksibël dhe më pranë studentëve. Marrëdhëniet me stafin akademik dhe administrativ me studentët ishin mjaftueshmërisht të mira edhe pse në kushte pandemie. Studentët nuk

përrjashtuan vështirësitë e fillimit deri sa u mësuan me mësimin online, edhe pse vitet e dyta dhe të treta kishin ekspëriencë nga semestri i dytë i vitit të kaluar akademik. Studentët theksuan disa herë se ndiheshin kërenarë që kanë bërë zgjedhjen e duhur për sa i përket studimeve të tyre në UMSH dhe entuziast që metoda e përdorur e mësimin online bëri të mundur që të mos humbnin vitin akademik. .

- Anëtarët e njësisë kanë sensibilizuar studentët që të jenë sa më aktivë në jetën studentore
- Njësia ka kërkuar bashkëpunimin e përfaqësuesëve të studentëve për plotësimin me rigorozitet të formateve të dosjes së praktikës në sistemin Bachelor dhe Master; për pjesmarrje të lartë në mësim gjatë semestrit të dytë në mësimet online si dhe sensibilizim të studentëve për të qenë sa më aktiv në jetën studentore. Në lidhje me këtë të fundit vlen të vlerësohet aktivizimi i lartë i studentëve në krijime dhe publikime të reflektimeve, shkrimeve në gazete dhe videomesazheve të ndryshme, përgjate pandemisë.
- Njësia ka kërkuar që studentët të shprehin lirshëm kërkësat dhe shqetësimet e tyre, në mënyrë që të merren masat e duhura nga Drejtimi për kapërcimet e tyre.
- Etj.

UMSH, 30.07.2021

Dr. Holta Heba

**Drejtuese e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm,
të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave, UMSH**